



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 462 Prot.

Gjirokastrë, më 30/04/2020

V E N D I M

Nr. 18, datë 30.04.2020

PËR
DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN E
ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

Mbështetur në ligjin 80/2018 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", urdhrin nr. 8, datë 14.01.2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar më urdhrin nr. 99, datë 26.03.2020 për disa ndryshime në urdhrin nr. 8, datë 14.01.2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë".

V E N D O S I:

Në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë" miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.13 datë 07.02.2020, bëhen shtesa dhe ndryshime si më poshtë vijon:

1. Në aneks nr.1 "Formular vetëdeklarimi" pas paragrafit të fundit shtohet : ' dhe si të tilla deklaroj se mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim duke theksuar se jam i/e gatshëm të provoj atë në rast se më kërkohet nga ana e strukturave përgjegjëse. Jam në dijeni se pasaktësia e informacionit (qoftë edhe pa paramendim) më heq të drejtën për të më marrë në konsideratë aplikimin e mësipërm."
2. Të gjithë personat e zgjedhur do të nënshtrohen kontrollit antiplagjiaturë nëse do të jetë e nevojshme sipas procedurave të përcaktuara në senatin akademik

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Bektash MEMA